

Permbledhje joteknike
Per aktivitetin:
“Impiant fraksionimi inertesh”

Subjekti: ALBA INERTE & KONSTRUKSION SHPK

Tirane, 2021

➤ **Kuadri ligjor shqiptar**

- Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”
- Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »
- Urdhrrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”.
- Udhëzimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”
- Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”
- Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”
- Ligji nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »
- Udhëzim i MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së’
- VKM nr. 686 datë 29.7.2015, “Për miratimin e rregullave të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.
- Ligji 12.2015 date 26.02.2015 ”Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440 datë 7.7.2011”Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”.

Objektivat e VNM-se jane:

- Të japë informacion mbi vendndodhjen e sheshit të projektit dhe të analizojë tiparet mjedisore;
- Të japë informacion mbi projektin teknik për fazën përgatitore, implementimin, marrjen e rezultateve të projektit, punimeve dhe mjeteve që do të përdoren, kompletimin dhe fazën përmbyllëse të tij;
- Të vlerësojë ndikimet e mundshme në mjedisin përreth dhe në banorët e zones
- Te identifikojë masat zbutese per ndikimet negative ne mjedis
- Tehartoje planet dhe masat per mbrojtjen e mjedisit

➤ **Pozita gjeografike**

Tirana ndodhet 110 metra mbi nivelin e detit. Lartësia mesatare e fushës së Tiranës është 521 m, kurse dy malet më të larta rrëz të cilëve shtrihet janë Mali i Dajtit me 1612 m dhe Mali me Gropa me 1828 m. Qyteti gjendet rreth 34 kilometra larg detit Adriatik në perëndim. Nga jugu dhe perëndimi rrethohet nga kodra relativisht të ulta, kurse nga ana veriperëndimore Tirana shtrihet mbi një zonë të rrafshët. Në periferinë veriore kalon lumi i Tiranës. Disa kilometra më tutje nga ana jugore rrjedh lumi i Erzenit. Sipërfaqja e qytetit të Tiranës është rreth 31 km², ndërsa sipërfaqja e gjithë rrethit është 1288 km² dhe përfshin katër qendra: Tiranën, Vorën, Krrabën dhe Kamzën si dhe 150 fshatra. Qendrën e Tiranës e përshkon përroi i Lanës i cili në grykëderdhje bashkohet me lumin Ishëm.

Kushtet klimatike

Ajri është me lageshti mesatare 60-80%. Përse i përket cilësisë së ajrit ai konsiderohet jo shumë i ndotur pasi zona nuk është zone industriale që të prodhojë gaze ndotëse për ajrin. Ndotja e ajrit vjen vetëm nga pluhurat që krijohen nga levizja e automjeteve apo dhe aktivitete të tjera njerëzore. Temperatura mesatare vjetore është 16°C. Sasia mesatare e reshjeve është 1297mm. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit 57m.

Tirana ka 331 ditë me diell në vit dhe këto kushtëzohen nga pozicioni gjeografik, vranësirat dhe pozicioni i vendit të matjes. Intensiteti i rrezatimit të drejtpërdrejtë i diellit është më i lartë në muajin Maj, ndërsa më i ulët në Dhjetor. Kurse vlera më e lartë në mesditë është gjatë muajit Korrik. Reshjet në Tiranë kryesisht përfaqësohen nga rëniet e shiut, që kapin shifrën 128 -139 ditë reshje në vit. Lagështia mesatare ditore e ajrit është rreth 72%. Tirana ka një thatësi të zgjatur që varion nga 9 deri 11 javë në vite.

Tirana - Temperatura dhe reshjet mesatare mujore

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrikk	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Ø	
Temp. Maks. (°C)	12	12	15	18	23	28	31	31	27	23	17	14	Ø	20,9
Temp. Mini. (°C)	-8	-8	-4	-1	3	6	11	10	5	1	-3	-7	Ø	0,4
Reshje (mm)	135	152	128	117	122	86	32	32	60	105	211	173	Σ	1.353

Era

Eshte një element shumë i ndryshueshem nga një zonë në një tjetër për shkak të ndikimit të madh që relievi ka mbi të. Megjithatë, duke marrë parasysh kushtet gjeografike të zonës dhe relievit përreth, erërat nuk karakterizohen nga një shpejtesi e madhe . Erërat mbizotëruese janë kryesisht lindore dhe juglindore dhe ndonjëherë ka erëra te nxehta .

Lagështia

Zona ne fjale eshte e karakterizuar nga një nivel relativisht i lartë i lagështisë, me një vlerë vjetore mesatare prej 73%. Vlera më e ulët është vërejtur në korrik me 67% dhe më të lartë në dhjetor me 76%.

Toka/Flora/Fauna

Tokat ne kete zone jane ngjyre hiri, kafe qe shtrihen ne formen e brezave vertikale deri ne lartesite me te medha te zones. Ky ekosistem perfaqesohet nga tokat e mbjella me kultura te ndryshme bujqesore dhe nga druret frutore qe jane mjaft te perhapur ne kete rajon. Toka e zones nuk eshte e kultivueshme dhe nuk perfaqeson siperfaqe te shfrytezueshme si kullote.

➤ **Pershkrimi I aktivitetit**

Subjekti ALBA INERTE & KONSTRUKSION SHPK, me nr, NIPT-I : M1411032E, me vendndodhje Rruga 5009, Lagjia Qarri, Zall Herr, Tirane, do te ushtroje aktivitetin Impiant fraksionimi inertesh.

Impianti i thyerje fraksionimit perbehet nga

1. Bunkeri i pranimit te gurit gelqeror
2. Sistemi i shtyrjes se gurit gelqeror me parimin e biell-manivel
3. Sistemi i pastrimit te gurit gelqeror me vibrim ne te thate qe largon dherat 0-24 mm ne nje trasportier 1 te vecante depozitohen ne sheshin e depozitimit te inerteve
4. Frantoja me cekica horizontal te vendosur ne aks per thyerjen e gurit gelqeror
5. Me hapësire te hyrjes se gurit 1.2*0.8 m dhe me madhesi te gurit deri ne 0.6 m dhe pas copetimit shkon 0-120 mm.
6. Transportieri 2 qendror me gjeresi rripi 1.2 m dhe gjatesi 30 m. Materiali nga transportieri shkarkohet ne sistemin e sitave vibruese.
7. Sistemi i sitave vibruese, me dimension 4m dhe 2.4 m, perbehet nga tre sita dhe prodhon kater fraksione.
8. Sita 1 me dimension 4x4 mm shkarkojne ne transportierin 3 reren e betonit me dimension 0-5 mm.
9. Sita 2 shkarkon me ane te transportierit 4 granil 1 , me dimension 5-12 mm
10. Sita 3 shkarkon me ane te transportierit 5 granil2, me dimension 12-25 mm
11. Mbetjet e gurit gelqeror mbi siten 3 me madhesi mbi 25 mm transportohen ne mullirin e thyerjes 1 dhe 2 me trasportirin nr 6.
12. Pas inertet kalojne ne sistemin e sitave vibruese me dy ndarje qe prodhon tre fraksione perkatesisht granil 1, me dimension 4-12 mm dhe granil 2 me dimension 12-24 mm.

Bunkeri lendes se pare te inerteve perbehet nga keto pjese:

- Bunkeri metalik
- Ushqyesi frantojes qe vihet ne levizje horizontale nga nje sistem bjelle manivele me elektromotor me fuqi 21kw
- Vibratori pastrimit te inerteve qe vihet ne levizje me elektromotor me fuqi 11 kw.
- Frantoja e thyerjes me çekiç te vendosur ne aks horizontal dhe qe vihet ne pune nga nje elektromotor me fuqi 135 kw me rripa trasmesioni trapezoidal qe levizin pulexhon aktive dhe pasive.

Tranportieri nr 1

Eshte transportieri i dherave te larguar nga guri gelqeror.

Trasportieri nr.2

Fraksioni i thyer ne frantoje nepermjet hinkes se frantojes bie ne trasportjeren nr. 2.

Trasportieri vihet ne levizje me elektromotor 18kw.

Sistemi sitave

Sistemi sitave nr. 1 perbehet nga tre kate dhe fraksionon 4 fraksione, si:

-Rere betoni	0-5mm
-Granil "1"	5-12mm
-Granil "2"	12-25mm
-Cakell	30-70mm

Fraksionet si me siper, shkarkohen respektivisht ne trasportieret nr ,3,4 dhe 5.

Fraksioni me dimension 30-70mm me ane te trasportierit 6 shkarkohet ne mullirin e thyerjes te shkalles se dyte. Pasi inertet kalojne ne sistemin e sitave vibruese me dy ndarje qe prodhon tre fraksione perkatesisht granil 1, me dimension 4-12 mm dhe granil 2 me dimension 12-24 mm.

Mulliri thyerjes se shkalles se dyte

Mulliri thyerjes se shkalles se dyte eshte kontruksion mekanik me hapesire pune 104cm, me lama te vendosura ne distance 8mm. Thyrja e inerteve behet me cekica, te cilet vihen ne levizje nga nje elektromotor me fuqi 135kw me 1200 rrotullime/minute.

Inertet me fraksion 30-70mm ne thyerjen e shkalles se dyte coptohet ne madhesin 0-5mm. Fraksioni 0-5mm nga hinka e bunkerit bie ne transportierin 6 dhe prej andej dergohet ne sistemin e sitave nr. 2 me dy kate.

Paneli komandimit te impiantit

Paneli vendoset prane bunkerit te lendes se pare ne pozicion dominues qe te kete pamje vizuale mbi te gjithë linjen e prodhimit te inerteve.

Panelisti pasi sigurohet se prane mekanizmave qe jane ne levizje nuk ka punonjes e ve ate ne pune. Eshte rregull qe leshimi impiantit ne pune fillon nga paisjet fundore deri tek ushqyesi frantojes se thyerjes se inerteve. Ndersa ndalimi linjes behet ne te kunderten, ndalohet ushqimi frantoje, pas tij sistemi pastrimit, frantoja, trasportieri deri tek trasportieret fundore.

➤ **NDIKIMET NEGATIVE NE MJEDIS**

○ **Shkarkimet e zhurmës**

Zhurmat kryesisht vijnë :

- Nga mjetet e transportit të gurit gelqeror

Paisjet e makinerit që do përdoren në këto aktivitete do plotësojnë direktivën 2000/1/14/CE të Parlamentit Evropian dhe të KE 8 maj 2000, do jenë të standartit të aplikueshëm në BE për zhurmat. Gjate fazës së funksionimit vlerësojmë se niveli akustik i zhurmës në impiantin e fraksionimit nga mjetet motorrike është më i ulët se zhurma që krijohet në zonat urbane . Siç thame edhe më sipër, zhurmat që do të krijohen gjate procesit të punës në objekt janë vetëm ato të shkaktuara nga makineritë dhe pajisjet e impiantit

○ **Vibracionet**

Duhet theksuar që në këto aktivitete nuk ka ndikime nga vibracionet, nuk ka makineri të renda të cilat krijojnë vibrime. Objektet e banimit ndodhen larg zonës që do të shfrytëzohet.

○ **Shkarkimet në ajër**

Gjate proceseve të punës së fraksionimit të inerteve ka tendencë të shkarkimit të pluhurave në ajër nga derdhja e materialit apo edhe nga rruget e impinatit por drejtues të shoqërisë do të marrin masa, të bëjnë të mundur lagjen e rrugëve dhe shesheve të punës me qëllim shmangien e ngritjes së pluhurit në ajër.

○ **Shkarkimet në ujë**

Gjate proceseve të punës për fraksionimin e inerteve, nuk kemi përdorim të ujit në procese. Ujërat e ndotura urbane higjieno sanitare do të shkarkohen në një gropë septike dhe nga aty do të terhiqen nga një kompani e licensuar.

○ **Shkarkimet në tokë**

Gjate fazës normale të operimit të projektit nuk do të ketë emetime të gazeve, lengjeve, mbetjeve të ngurta toksike dhe lende të tjera të demshme që mund të shkarkohen në ajër dhe tokë, të lidhura me teknologjinë e përdorur, të cilat mund të ndikojnë negativisht në

shendetin e punetoreve, banoreve per rreth, mjedisin floren dhe faunen e zones. Mbetjet urbane te gjeneruara do te grumbullohen ne kosha te posacem ku me pas largohen per ne vendgrumbullimet e percaktuara nga pushteti vendor.

➤ **MASAT PER NDIKIMET NEGATIVE NE MJEDIS**

○ **PLUHURAT**

Ne fazen e funksionimit te aktivitetit linjes se prodhimit te inerteve , do te behet sprucimi me uje ne forme pulverizimi, te rugeve dhe ambjenteve, ku punohet dhe levizin mjete, dhe shesheve ku punohet per hapjen e bazamenteve. Ne fazen e shfrytezimit te linjes pluhur mund te krijohet vetem ne piken 'A' sipas skemes teknologjike ne pjacalen e shkarkimit dhe hedhjes se mineralit ne bunker. Pjacula ne periudhen e thate do mbahet e lagur me uje, me sprucim . Ajri pas ketij procesi nuk do te permbaj grimca pluhuri.

Aktiviteti nuk sjell emetime te gazeve ne atmosfere sepse nuk perdore lende djegese gjate zhvillimit te aktivitetit te tij shfrytezues.

Lenda djegese perdoret vetem nga mjetet e transportit te lendeve te para si dhe produktit perfundimtar. Per mbrojtjen nga gazet e motorreve diezel do te merren keto masa :

1. Mjetet motorrike do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore.
2. Ato do te jene te pajisura ne marmita me katalizatore per kapjen e gazeve toksike.

○ **ZHURMAT**

Masat qe do te merren per minimizimin e zhurmave nga ana e shoqerise jane:

- Makinat e transportit do jene te pajisura ne marmita selenciatore te pakesimit te zhurmave.
- Per te ulur me tej ndikimin nga zhurmat punetoret detyrimisht do te perdorin paisjet e mbrojtjes ne pune "kufje"

- **UJERAT**

Sic eshte theksuar edhe me siper ky proces nuk shkarkon ne mjedis uhor prites ujera te ndotura. Ujerat e shiut do te mblidhen permes kuletave dhe do ti bashkohen prroskave te zones. Ujerat e ndotura urbane higjeno sanitare do te shkarkohen ne nje grope septike dhe nga aty do te terhiqen nga nje kompani e licensuar.